

KONKURS

Бр.-Nr. 02-58/2
20-07 2021 год.-viti
КУМАНОВО - КУМАНОВЕ

Për regjistrimin e nxënësve në vitin e parë për v.sh. 2021/2022)

Në bazë të konkursit të dale nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për regjistrimin e nxënësve në shkolla të mesme publike për vitin shkollor 2021/2022 në Republikën e Maqedonisë së Veriut .

SHMK. Gjimnazi "Sami Frashëri"-Kumanovë për vitin e parë ka 238 vende të lira për regjistrim, sipas planeve dhe programeve mësimore për drejtim të gjimnazit me drejtimet: **matematiko-natyror (komb. A,B), shoqëror-humanist (komb. A,B), me minimum 60- pikë.**

Paraqitja parë për regjistrim në afatin e qershorit realizohet me **14 qershor 2021 me fillim ora 12:00 deri 19:00 dhe më 15 dhe 16 . qershor 2021 me fillim në ora 7:00 deri ora 19:00, më 17. qershor 2021 me fillim ora 07:00 deri ora 15:00,** konfom përgatitjes së orarit nga ana e shkollës . Rang lista me rezultatet e regjistrimit dhe vendet e lira shpallet më **17. qershor 2021 prej orës 16:00** deri ora 19:00

Paraqitja dytë për regjistrimin e nxënësve është si në vijm **më 23 dhe 24. qershor 2021 me fillim ora 07:00 deri 19:00 dhe më 25 . qershor 2021 me fillim në ora 7:00 deri ora 15:00, konfom përgatitjes së orarit nga ana e shkollës . Rang lista me rezultatet e regjistrimit dhe vendeve të lira shpallet më 25. qershor 2021 prej orës 16:00 deri ora 19:00**

Paraqitja tretë për regjistrimin e nxënësve ktyhet më **30. qershor 2021 me fillim ora 07:00 deri 19:00 , konfom përgatitjes së orarit nga ana e shkollës . Rang lista me rezultatet e regjistrimit dhe vendeve të lira shpallet më 01. korrik . 2021 ora 12:00.**

Nxënësit që janë në riprovim, provim klasor, provim për përparim të shpejtë , mundë të regjistrohen në shkollat ku ka vende të lira , pas afatit të qershorit , më 23. gusht. 2021 .

Pas shpalljes së rangë listave me rezultatet e regjistrimit , nxënësit që nuk i plotësojnë kushtet për rregjistrim në shkollë , janë të detyruar tërë dokumentacionin të dhënë në shkollë ta tërheqin në afat prej 48- orëve , kurse shkollat kanë obligim të kthejnë gjithë dokumentet nxënësit brenda 48-orëve
KUSHTET PËR REGJISTRIM NË SHKOLLËN E MESME-ARSIMIM GJIMNAZOR:

- Të kenë të kryer shkollimin fillor
- Të mos jetë më i vjetër se 17 vjet

- Të përcaktohet për shkollim gjimnazor sipas drejtimeve të lartëpërmendura
- Transporti falas apo akomodimi i nxënësve të cilët do të regjistrohen në vitin e parë në shkollat e mesme publike, nuk do të sigurohet nëse lloji i zgjedhur arsimor (drejtimi) ekziston në komunën, respektivisht në regjionin nga vjen nxënësi.

DOKUMENTET E DUHURA PËR REGJISTRIM

1. Fletëparaqitje për regjistrim (e marr nga shkolla)
2. Dëftesat origjinale prej klasës së gjashtë deri në klasën e nëntë
3. Çertifikata origjinale nga libri amzë i të lindurve
4. Diploma nëse nxënësi ka arritur vendin e I, II, III në gara shtetërore dhe ndërkombëtare

KRITERET PËR ZGJEDHJE

Përveç kushteve të lartëshënuara kandidati duhet të arrijë minimum 60 pikë për regjistrim në gjimnaz.

Suksesi i përgjithshëm i nxënësit prej klases së VI-të deri në klasën e IX-të (maksimum 50 pikë nëse nxënësi ka qenë i shkelqyeshëm në të gjitha lëndët mesimore)

Suksesi mesatar në katër lëndë (Gjuhë shqipe dhe letërsi, Matematikë, Gjuhë angleze dhe Histori-maksimumi 20 pikë)-për drejtimin shoqëroro humanist lëmia –A,B

Suksesi mesatar në katër lëndë (Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gj. angleze Matematikë, Fizikë(komb.A) dhe Biologji(komb. B) -maksimumi 20 pikë)-për drejtimin matematiko natyror lëmia –A,B

Diploma të fituara (I,II dhe III), vende në gara Republikane dhe ndërkombtare (nga gjuha amtare, gjuhë të huaj, Matematikë dhe Histori)

Vlera mesatare e pikëve të fituara për sjellje gjatë shkollimit fillorë (sjellja shembullore fiton 5 pikë, sjellja e mire 3 pikë)

Nxënësi sipas të gjitha kritereve të caktuara me këtë konkurs mund të fitojë më së shumti 80 pikë.

Prill, 2021
Kumanovë


Drejtori
Afrim Aliti